

ESTIUOIL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS08

Fjalë sinjalizuese : RREZIK

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

ESTIUOIL është insekticid-akaricid kontakti me bazë vaji mineral parafinik me rafinim të lartë, i cili përdoret në trajtimet dimërore dhe pranvero-verore për kontrollin e formave dimëruese dhe aktive të breshkëzave, këpushave, tripseve, psillave, krahë bardhave, micelit të parazitëve këpurdhor si dhe ka veprim ovicid dhe repellent ndaj larvave të lepidopterëve. Vepron duke mbuluar trupin e insektit me një shtresë vajore, e cila bllokton sistemin trakeal të frymëmarrjes.

Permbajtja: Vaj mineral parafinik 94% (98% i pa sulfonueshem)

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm (EC)

Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni larg mundësive të arritjes prej fëmijëve.
- Ruajeni larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin.
- EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.
- P405: Ruaje në mjedise të mbyllura.
- P501: Asgjesoni produktin/enën në përputhje me rregulloret në fuqi për mbetjet e rrezikëshme.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H304: Mund të jetë fatal në rast të gjëllitjes dhe depërtimit në traktin respirator.
- P301+P310+P331: NËSE GËLLTITET: kontaktoni menjëherë një Qendër Antihelmimi/një mjek. Mos provokoni të vjella.
- Në rast kontakti me lëkuren ose mukozat, lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Në rast thithje të tretësirës spërkatëse me organet e frymëmarrjes, i aksidentuari cohet në një mjedis të ngrohtë dhe të ajrosur.
- Kërkoni menjëherë ndihmë në qendrën më të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën e këtij produkti. Aplikohet terapi simptomatike.

Përdorimi:

Në trajtimet dimërore: në pemtari, vreshta, agrume, ullinj: kundër formave dimëruese të breshkëzave, këpushave eriofide dhe tetranikide, minueseve, afideve, tripseve, pambukoreve, krahe bardhave, psillave e lepidoptereve të ndryshëm. Doza e përdorimit: 1.5-2%. Në përzierje me insekticide e fungicide me bazë bakri, doza e përdorimit është 1%.

Në trajtimet në vegjetacion: Agrume, kundër merimangave dhe breshkëzave. Doza e përdorimit 1 lit/100 lit uje, shpërndarë me 1000-2000 lit ujë/ha, ose 10-20 lit produkt/ha.

Ullinj, kundër breshkëzave, pambukores. Doza e përdorimit: 0,75-1 lit/100 lit ujë, e shpërndarë me 500-1500 lit/ha ose 3.75-15 lit produkt/ha.

Pemë frutore, kundër vezëve dhe formave të lëvizëshme të breshkëzave, këpushave eriofide dhe tetranikideve, minueseve të gjetheve, afideve, tripseve, pambukoreve, krahë bardhave, psillave e lepidoptereve të ndryshëm. Doza e përdorimit: 0,75-1 lit/100 lit ujë, e shpërndarë me 500-1500 lit/ha ose 3.75-15 lit produkt/ha.

Vërejtje për përdorimin:

Përdorni vëllime të plota uji për spërkatje për të siguruar lagjen e plotë të bimësisë së trajtuar. Trajtimet është mire të ndërpriten kur frutat fillojnë ndryshimin e ngjyrës.

Nuk perzihet dhe mos e aplikoni produktin para se të kalojnë të paktën 40 ditë nga trajtimi me squfur, polisulfide, kapan ose folpet. Të përdoret ekskluzivisht sipas kushteve të treguara në këtë etiketë.

Fittoksiciteti:

Nuk është fitotoksik në kulturat dhe dozat e rekomanduara në këtë etiketë. Mos kryeni trajtime në ditë të nxehta dhe të thata.

Ndikimi në ekosistem:

Nuk është helmues për bletën dhe organizmat ujore. Mos trajtoni në kohe me erë. H410: Shumë toksike për jetër jetën ujore me efekte të zgjatura. SP1: Mos e ndotni burimet e ujit, lumenjtë, përrejtë, kanalet ujitës ose kullues, digat me produktin ose ambalazhin e tij. Për mbrojtjen e gjallesave ujore mos trajtoni në parcelat të cilat janë më pak se 10 m larg sipërfaqeve ujore. Mos pastro mjetet e aplikimit në afersi të ujërave sipërfaqësore. Mos ndotni ujrë me produktin ose enën e tij.

Karenca:

Nuk aplikohet.

Magazinimi:

Të ruhet në temperaturë 5-40⁰ C, në vënde të freskëta e të thata, të ajrosura mirë dhe ne mungese të rrezatimit diellor.

Nr. dhe data e regjistrimit: 730, datë 24.4.2020.

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vjet

Numri i serisë:

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: 100 ml, 1 lit.

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE.

Aplikanti: RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U., **Adresa:** Pol. Ind. Fondo de Litera, Autovía A-2 Km 441.6 22520 Fraga (HUESCA) SPANJË.

Prodhuesi: 1. RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U. **Adresa:** Pol. Ind. Fondo de Litera, Autovia A-2 Km 441.6, 22520 Fraga, (HUESCA) SPANJË.

2. SHANDONG WEIFANG RAINBOW CHEMICAL CO. LTD, **Adresa:** Binhai Economic Develoment Area, Weifang, Shandong 262737, KINË.

Ambalazhues: .